



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.147/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesat e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të vendosjes së posterave në shtyllat publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**PRANOHEN** si të bazuara ankesat e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, Anr.147/17, Anr.148/17 dhe 149/17 e datës 07.06.2017, kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,900.00 (dymijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

PZAP-i me datën 07.06.2017, ka pranuar tri ankesa, ankesën Anr 147/2017 , Anr 148/2017 dhe Anr 149/2017 të parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në të cilat pretendojn se me datën 07.06.2017 aktivistët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA kanë vërejtur se në qytetin e Gjilanit subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka vendosur posterin e kandidates së saj për deputete në shtylla publike, veprime këto që sipas parashtruesit përbëjnë shkelje të dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së dhe 4.1 pika b) i Regullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013. Ankuesi në mbështetje të pretendimeve në ankesa kanë bashkangjitur disa fotografi të printuara nga vendi i shkeljes së pretenduar.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me nr.Anr 147/2017 për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të tri ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP me datë 07.06.2017 subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje ka dërguar kërkesë dhe urdhër për ndërmarrjen e veprimit për përmirësim.

Koalicioni PDK-AAK-NISMA, me datën 08.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës, në të cilën kanë deklaruar se tërhiqemi nga të gjitha ankesat që nuk kanë vendim përfundimtar, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, gjeti se:

### **Ankesat janë të bazuar**

Paneli vlerëson nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e kandidatës për deputete nga radhët se subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtylla publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: *“ Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike ”.*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga ky subjekt janë vendosur në shtyllat publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtylla publike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.147/2017 Anr.148/2017 Anr.149/2017 e datës 07.06.2017, të parashtruara ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që *“Tërheqja e njërës prej palëve të*

*interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim”. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesave sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.147/2017 më datën 09.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.